

Instituti për Studime të Avancuara - GAP

Letërnjoftimi i Komunës së Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit

Janar, 2013

“Letërnjoftimi i Komunave” është projekt i Institutit GAP i cili vlerëson qeverisjen komunale dy vite pas zgjedhjeve lokale të 2009. Ky projekt është implementuar në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC). Rezultatet e hulumtimeve të GAP për qeverisjen komunale janë debatuar me kryetarët e komunave në emisionet “Jeta në Kosovë”.

Përmbajtja

1. Hyrje	3
2. Komuna e Zveçanit.....	6
3. Komuna e Zubin Potokut	9
4. Komuna e Leposaviqit	12
5. Zyra Administrative e Mitrovicës së Veriut	14
6. Përfundim	17
7. Burimet:	19

1. Hyrje

Në territorin e Kosovës zyrtarisht numërohen 37 komuna, pa përfshirë këtu edhe zonën e veriut të Komunës së Mitrovicës, e njohur zyrtarisht si Zyra Administrative e Mitrovicës së Veriut (ZAMV), e cila planifikohet të krijohet si njësi e re komunale, duke e rritur kështu numrin e komunave në 38. ZAMV është krijuar me një vendim të Qeverisë së Kosovës, e cila numëron mbi 70 të punësuar dhe struktura e kësaj zyre ngjason me strukturën e komunave tjera në vend.¹

Në pjesën veriore të Kosovës, duke e përjashtuar Mitrovicën e Veriut, funksionojnë tri komuna, Leposaviqi, Zveçani dhe Zubin Potoku. Në këto tri komuna ekziston një numër organesh të ndara mes vete, disa i japin llogari institucioneve të Kosovës e disa të tjera atyre të Serbisë. Në Zubin Potok dhe Zveçan, kryetarët e komunave ushtrojnë funksione të dyfishta. Paralelisht llogariten kryetarë të komunave të çertifikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Kosovës dhe të njëjtën kohë llogariten kryetarë të komunave të mbështetur nga Qeveria e Serbisë. Kryetarët e komunave në Zveçan dhe Zubin Potok marrin buxhet edhe nga Qeveria e Kosovës, por njëherazi buxhet dhe mbështetje politike marrin edhe nga Qeveria e Serbisë, të cilëve edhe u raportojnë.²

Organet me të fuqishme të institucioneve të Kosovës në veri janë Zyrat Komunale për Komunitete, të cilat udhëhiqen nga shqiptarët dhe funksionojnë jashtë objekteve komunale dhe përpiqen të qeverisin sipas rregullave të përcaktuara nga ana e nivelit qendror të Kosovës. Ndonëse këto zyra janë të parapara vetëm për të promovuar të drejtat e komuniteteve jo shumicë, ato ushtrojnë edhe funksione të dhënies së dokumentacionit civil si dhe kryerjen e shërbimeve të tjera komunale. Zyrat Lokale për Komunitete janë themeluar sipas rregulloreve të UNMIK-ut mbi organizimin dhe funksionimin e qeverisjes lokale në Kosovë, në fillim të vitit 2001 në Leposaviq dhe Zubin Potok dhe në qershor të vitit 2002 në Zveçan. Zyra Komunale për Komunitete për Komunën e Leposaviqit është në fshatin Bistricë, ajo për Komunën e Zubin Potokut është në fshatin Çabër, kurse ajo për Komunën e Zveçanit është në fshatin Lipë. Në gusht të vitit 2010, Qeveria e Kosovës ka nxjerrë Rregulloren nr. 02/2010 për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim.³ Këto zyra kanë për qëllim mbrojtjen dhe promovimin e të drejtat të komuniteteve, qasje të barabartë për të gjitha komunitetet në shërbimet publike, si dhe krijimin e kushteve për kthim të qëndrueshëm të të zhvendosurve dhe personave të riatdhesuar. Zyrat Komunale për Komunitete në

¹ Qeveria e Kosovës. Zyra e Kryeministrit. Vendimi 01/75. Data 23.05.2012. Burimi: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_75-te_te_Qeverise_se_Republikes_se_Kosoves_2012.pdf

² Bisedë me Haki Imerin, udhëheqës i Zyrës Lokale për Komunitete në Leposaviq dhe bisedë me Qerkin Veselin – udhëheqës i Zyrës Lokal për Komunitete në Zubin Potok. Bisedat janë zhvilluar me datë 11.12.2012 dhe me datë 12.12.2012.

³ Qeverisë e Kosovës. Zyra e Kryeministrit. Zyra Ligjore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Rregullorja për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim. Burimi: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Rregullore_per_Zyrat_komunale_per_Komunitete_dhe_Kthim.pdf

Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok kryejnë funksione të tjera si lëshimi i të gjitha llojeve të certifikatave civile (lindje, vdekje, shtetësisë), lëshimi i dokumenteve të udhëtimit (pasaporta, letërnjoftime, patentë shofer), ofrimin e shërbimeve të rrjetit dhe mirëmbajtjes elektrike, shërbimet publike (uji, rrugët, pastërtia), investimet kapitale (ndërtimi i rrugëve, shkollave, terreneve sportive, ujësjellësin).

Asnjë nga këto tri komuna nuk e respektojnë juridiksionin e shtetit të Kosovës dhe nuk i përfillin asnjë nga parimet bazë të qeverisjes lokale të vendit. I gjithë dokumentacioni i tyre dhe rregullat e funksionimit të tyre janë të bazuara në ligjet dhe parimet e nxjerra nga Qeveria e Serbisë për qeverisje lokale. Shmangia e këtyre komunave nga llogaridhënia dhe përgjegjësia në raport me institucionet e Kosovës ka rrjedhur gradualisht. Largimi total ka ngjarë në vitin 2010, dy vite pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Deri në atë kohë, këto komuna kanë pasur bashkëpunim të pjesshëm me institucionet e Kosovës. Leposaviqi, Zveçani dhe Zubin Potoku deri në këtë periudhë (2010) kanë dërguar nga një raport vjetor në Ministrinë e Financave në lidhje me shpenzimet e buxhetit dhe ecuritë tjera financiare. Po ashtu në këto tri komuna është bërë për çdo vit (deri më 2010) auditimi nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (ZAP). Njëherit, këto komuna kanë pasur një bashkëpunim periodik me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe me institucionet tjera gjegjëse.

Nga ana tjetër, Institucionet e Kosovës i llogarisin këto komuna si pjesë integrale të sistemit politik të vendit dhe si rezultat granti për komuna i Qeverisë së Kosovës ndahet duke i llogaritur edhe komunat e Zubin Potokut, Leposaviqit dhe Zveçanit. Këto komuna nuk kanë kundërshtuar asnjëherë marrjen e buxhetit nga institucionet e Kosovës, por kanë kundërshtuar të raportojnë për ecurinë e shpenzimeve të buxhetit dhe krijimin e bashkëpunimit ndër-institucional. Këto komuna kanë kundërshtuar edhe pjesëmarrjen në regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, i zhvilluar në prill të vitit 2011.

Pothuajse të gjithë mësimdhënësit serb në komunat e veriut marrin pagë nga Qeveria e Kosovës, por plan programi i mësimin bazohet në rregullat e caktuara nga Qeveria e Serbisë. Pagën nga Qeveria e Kosovës e merr edhe Kryetari i Komunës së Zveçanit dhe ai i Zubin Potokut dhe një pjesë e madhe e administratës komunale në këto komuna. Në Leposaviq, pagat nga Qeveria e Kosovës i tërheqin vetëm mësimdhënësit serb, por jo edhe Kryetari i Komunës apo administrata komunale.⁴

Elektorati serb në veri të Kosovës, që përbën shumicën e popullatës në atë pjesë, ka bojkotuar zgjedhjet e organizuara nga autoritetet kosovare të mbajtura në nëntor të vitit 2007. Në dhjetor 2007, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) i OKB-së në Kosovë, Soren Jesen Petersen mori vendimin Nr. 2007/62 për ta vazhduar mandatin e Kuvendeve Komunale në këto tri komuna edhe për 6 muaj, të formuara në zgjedhjet

⁴ Bisedë me Lulzim Pecin, përgjegjës në Zyrën Lokale për Komunitete në fshatin Lipë të Zveçanit. Biseda është zhvilluar me 13 dhjetor 2012

lokale të vitit 2004, si dhe bëri emërimin e kryetarëve të këtyre komunave, gjithashtu edhe për një periudhë gjashtë mujore. Pas përfundimit të mandatit 6 mujor të këtyre organeve dhe si pasojë e mos nxjerrjes së një vendimi tjetër nga ana e PSSP-së për vazhdim të mëturshëm të mandatit të këtyre organeve, Qeveria e Kosovës mori vendim nr.25/02 për zgjatjen e mandatit të këtyre komunave deri në zgjedhjet e ardhshme lokale të 2009.⁵ Por, edhe në këtë vit, përgjegjësit e këtyre komunave refuzuan që të marrin pjesë në zgjedhjet e organizuara nga autoritetet e Prishtinës, duke gjetur kështu ende mbështetje në vendimin e Qeverisë së Kosovës 25/02/2008.⁶

Në pjesën në vazhdim, do të përshkruajmë veç e veç gjendjen e qeverisjes në tri komunat veriore të Kosovës: Zveçan, Leposaviç dhe Zubin Potok si dhe Zyra Administrative e Mitrovicës së Veriut.

⁵ Qeveria e Kosovës. Zyra e Kryeministrit. Vendimi 02/25. Data 03.07.2008. Burimi: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_25-te_te_Qeverise_2008.pdf

⁶ Qeveria e Kosovës. Zyra e Kryeministrit. Vendimi 02/25. Data 03.07.2008. Burimi: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_25-te_te_Qeverise_2008.pdf

2. Komuna e Zveçanit

Komuna e Zveçanit shtrihet në pjesën veriore të Kosovës dhe kufizohet me Komunën e Leposaviqit në veri, me Mitrovicën në jug dhe me Komunën e Zubin Potokut në perëndim. Kjo Komunë ka refuzuar t'i bashkëngjitet procesit të regjistrimit të popullsisë dhe për rrjedhojë nuk dihet shifra e saktë e numrit të banorëve në këtë komunë. Në komunën e udhëhequr nga serbët lokal pretendohet se jetojnë afërsisht 17.000 banorë, të koncentruar në zonën urbane të qytetit dhe në 35 fshatra sa llogaritet t'i ketë Komuna e Zveçanit.⁷ Komisioni qeveritar për ndarjen e granteve për komuna, proces ky i cili bazohet në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, llogaritet që në Komunën e Zveçanit jetojnë 16.000 banorë.⁸ Shqiptaret në këtë komunë banojnë kryesisht në tri fshatra, Boletin, Zhazhë dhe Lipë.

Kryetar i komunës së Zveçanit është Dragisa Milovic i cili vjen nga radhët e Partisë Demokratike të Serbisë (serb: DSS). Ai e ushtron këtë pozitë që nga viti 2004. Zëvendës kryetar është Miodrag Asiç nga radhët e Partisë Socialiste Serbe (serb: SPS). DSS dhe SPS bashkë qeverisin në Komunën e Zveçanit. Struktura e Komunës së Zveçanit dallon nga strukturat e komunave tjera të Kosovës. Kësisoj, kjo komunë ka gjithsej gjashtë drejtori: Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Rendit Publik, Drejtoria për Emergjencë, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim.⁹ Komuna e ka të formuar edhe Kuvendin Komunal i cili ka dal nga zgjedhjet e organizuara në vitin 2004 të cilit i është vazhduar mandati me vendim të Qeverisë së Kosovës.¹⁰ Kuvendi ka gjithsej 27 anëtarë, të gjithë të komunitetit serb. Nëntë prej tyre janë nga Partia Radikale e Serbisë, ndërsa pjesën tjetër e përbëjnë Partia Socialiste e Serbisë, Partia Socialdemokrate e Serbisë, Partia Demokratike e Serbisë dhe me nga një vend janë të përfaqësuar partia "G 17 plus" dhe subjekti politik Këshilli Nacional Serb. Dy subjektet e fundit janë të regjistruara në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të Kosovës dhe i janë nënshtruar procesit të auditimit si subjekt politik pranë KQZ.¹¹

Asnjë nga dokumentet e lëshuara nga ana e Komunës së Zveçanit nuk përmban logo apo ndonjë shenjë tjetër identifikuese të shtetit të Kosovës. Edhe uebfaqja zyrtare e kësaj

⁷ Faqja Zyrtare e Komunës së Zveçanit. Informatori i Komunës. Burimi:

http://www.opstinazvecan.rs/index.php?option=com_content&view=category&layout=blog&id=19&Itemid=129&lang=rs

⁸ Kuvendi i Kosovës. Ligji për Financat e Pushtetit Lokal. Burimi: http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L049_al.pdf

⁹ Komuna e Zveçanit. Sektorët operativ në komunë. Burimi:

http://www.opstinazvecan.rs/index.php?option=com_content&view=category&layout=blog&id=46&Itemid=140&lang=rs

¹⁰ Qeveria e Kosovës. Zyra e Kryeministrit. Vendimi 02/25. Data 03.07.2008. Burimi:

http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_25-te_te_Qeverise_2008.pdf

¹¹ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Raporti i Auditimit të Subjekteve Politike. Burimi: <http://www.kqz-ks.org/SKOZ-WEB/al/materiale/raportiauditimit2010.pdf>

Komune mban domenin 'rs' (Republika e Serbisë).¹² Dokumentet zyrtare të shtetit të Kosovës lëshohen vetëm nga ana e Zyrës Lokale për Komunitete në fshatin Lipë të Komunës së Zveçanit. Deri tani llogariten që mbi 2.300 serbë lokal të asaj zone janë pajisur me dokumente të ndryshme të shtetit të Kosovës.¹³

Në pesë vitet e fundit, Komuna e Zveçanit ka lidhur 17 kontrata publike përmes procedurave të prokurimit publik të Kosovës. Këto procedura janë iniciuar nga ana e Zyrës Lokale për Komunitete në fshatin Lipë dhe janë financuar nga buxheti i Kosovës, përmes granteve për Komuna, përkatësisht buxhetit të ndarë për Komunën e Zveçanit në sferën e investimeve kapitale. Në Ligjin e Prokurimit Publik të Kosovës në nenin 22 saktësohet së asnjë aktivitet i prokurimit nuk mund të iniciohet nga ana e autoriteteve kontraktuese pa i përmbushur kushtet ligjore të raportimit.¹⁴

Tabela nr.1: Kontratat e lidhura me procedurë të prokurimit në Zveçan në pesë vitet e fundit sipas fushës së investimeve, kostos, vitit dhe kompanive punë kryese

Projekti	Shuma (euro)	Viti	Kompania
Ndërtimi i linjës së tensionit të mesëm 6.3 KV mes fshatit Rudar i Madh dhe Rudar i Vogël.	21.998	2012	"Elektro Heta" Ferizaj & "Tak" - Zveçan
Elektrifikimi i fshatit Lipë.	77.938	2012	"Every Day"- Mitrovicë & "Elektro Heta" - Ferizaj
Ndërtimi i rrugëve lokale në fshatrat Boletin, Zhazhë dhe Lipë	562.703,48	2012	"Sabs"- Mitrovica & Kompania " Bejta Comerc"- Gjilan.
Ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Lipë 'Faza e Dytë'	419.999	2011	"Doni Comerc" - Skenderaj & "Euro projekt" - Mitrovica
Ndërtimi i kanalizimeve në fshatrat Boletin, Zhazhë dhe Lipë	240.142	2010	"Dino" - Lipjan
Ndërtimi i rrugëve lokale në fshatin Boletin i Epërm.	69.919	2010	"Konsorcijum: "Sabs"- Mitrovica dhe "Gashi" - Lipjan
Rregullimi për rreth objekteve ambulatore në fshatrat Lipë dhe Zhazhë	130.749	2010	"Astra Plan" - Prishtinë
Elektrifikimi i fshatit Boletin-Komuna e Zveçanit.	399.700	2010	Every Day"- Mitrovicë & "Elektro Heta" - Ferizaj
Furnizimi me pajisje për ambulatat në fshatrat Lipë dhe Zhazhë	51.545	2009	" Dreni Pharm"- Mitrovicë

¹² Ueb faqja zyrtare e Komunës së Zveçanit. Burimi: <http://www.opstinazvecan.rs/>

¹³ Bisedë me Lulzim Pecin, përgjegjës në Zyrën Lokale për Komunitete në fshatin Lipë të Zveçanit. Biseda është zhvilluar me datë 13 dhjetor 2012.

¹⁴ Kuvendi i Kosovës. Ligji i Prokurimit Publik. Burimi: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20prokurimin%20publik.pdf>

Ndërtimi i fazës së parë të ujësjellësit në fshatrat Boletin dhe Zhazhë	286.153	2009	“Nita” - Mitrovicë “Infra Plus” - Prishtinë
Faza e parë e ndërtimit të shkollës në Lipë	180.889	2009	“Europrojekt Plus” - Mitrovicë
Elektrifikimi i Lagjës Uka në fshatin Lipë	78.888	2009	“Every Day” - Mitrovica
Ndërtimi i ambulantes në fshatin Zhazhë	47.731	2008	“Euro Projekt Plus” - Mitrovica
Ndërtimi i ambulantes në fshatin Lipë	49.731	2008	“Euro Projekt Plus” - Mitrovica
Instalimi i ngrohjes qendrore ne shkollën fillore “Isa Boletini” në fshatin Boletin	39.858	2008	“Nita” - Mitrovicë
Ndërtimi i fushës sportive, parkingut dhe rrethojës rreth ZLK-ve në Lipë	71.679	2007	Konsorcijum “CTA - MABB” - Prishtinë

Buxheti i ndarë nga Qeveria e Kosovës për Komunën e Zveçanit në vazhdimësi ka pasur trend të rritjes, ndonëse kjo komunë në tri vitet e fundit nuk ka raportuar për mbledhjen e të hyrave komunale. Në nëntë mujorin e vitit 2012, nga Komuna e Zveçanit nuk është regjistruar asnjë euro e hyrë, ndërsa gjatë tërë vitit 2011 nga Komuna e Zveçanit janë raportuar të hyra në vlerë prej 450 eurove. Këto para ishin mbledhë nga Zyra Lokale për Komunitete në fshatin Lipë nga lëshimi i dokumentacionit civil.¹⁵

Sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të gjitha institucionet qendrore dhe komunale si dhe agjencitë qeveritare duhet t’i nënshtrohen auditimit financiar së paku njëherë gjatë një viti, si dhe duhet të bëjnë raportim periodik dhe vjetor financiar në departamentet përkatëse në Ministrinë e Financave.¹⁶ Asnjëra nga këto dy kriteret bazë të financave publike nuk respektohet nga ana e Komunës së Zveçanit. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm nuk ka qenë në gjendje të bëjë auditimin për Komunën e Zveçanit për vitin 2011 për shkak të refuzimit të tyre për bashkëpunim dhe raportim.¹⁷

Në anën tjetër, Qeveria e Kosovës ka ndarë miliona euro për çdo vit për Komunën e Zveçanit, për të përmbushur qarkoren buxhetore për komuna të paraparë më Ligjin për Financat e Pushtetit lokal.

¹⁵ Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave. Raporti vjetor i buxhetit 2012. Burimi: <http://mf.rks.gov.net/sq-al/ministriaefinancave/buxhetiirepublikessekosoves/buxheti-qendrore.aspx>

¹⁶ Kuvendi i Kosovës. Ligji për Financat Publike. Burimi: <http://www.assembly-kosova.org/?cid=1,191,6> & <http://www.assembly-kosova.org/?cid=1,191,7>

¹⁷ Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për Komunën e Zveçanit për vitin 2011. Burimi: http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KZV_2011_Shqip_978143.pdf

Tabela nr.2: Shuma e mjeteve që ka ndarë Qeveria e Kosovës për Komunën e Zveçanit në tri vitet e fundit.¹⁸

Kategoria	2010	2011	2012
Investime Kapitale	601.816	794.032	885.906
Subvencione	00	5.157	00
Shpenzime komunale	33.200	33.200	20.700
Mallra dhe shërbime	181.028	123.459	150.393
Paga	687.618	844.085	849.883
Gjithsej	1.503.662	1.799.933	1.906.882

Nga tabela e mësipërme shihet një rritje solide e buxhetit që e dedikon Qeveria e Kosovës nga viti në vit. Kësisoj, në vitin 2012 Komuna e Zveçanit ka pasur 106.949 euro më shumë buxhet së një vit më herët. Rritje më të theksuar të buxhetit për këtë komunë në tri vitet e fundit ka pasur në kategorinë e pagave. Afro 850.000 euro është shuma e mjeteve vjetore që alokohen në kategorinë e pagave për Komunën e Zveçanit.

Në tri vitet e fundit, numri i personave që tërheqin paga nga buxheti i Kosovës në Komunën e Zveçanit ka ardhur duke u rritur. Kësisoj, në vitin 2010 kanë qenë 222 persona nga kjo komunë që kanë marrë paga nga buxheti i Kosovës, një vit më vonë ky numër është rritur për shtatë persona, ndërsa në vitin 2012 numri serish ka shënuar rritje dhe deri në fund të këtij viti numri i përgjithshëm i atyre që tërheqin paga në Komunën e Zveçanit ka qenë 234 persona.

3. Komuna e Zubin Potokut

Komuna e Zubin Potokut shtrihet në pjesën veriore të Kosovës dhe kufizohet me pjesën e Malit të Zi në perëndim, me Komunën e Mitrovicës në jug, ndërsa në lindje me Komunën e Istogut dhe me Komunën e Skenderajt. Kjo Komunë ka rreth 350 kilometra katror dhe numëron 27 fshatra, prej tyre vetëm një vendbanim është i populluar me popullatë shqiptare, ndërsa të tjerat nga komuniteti serb. Edhe kjo Komunë ka refuzuar t'i bashkangjitet nismës së vitit 2011 të institucioneve të Kosovës për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, dhe për rrjedhojë nuk ka zyrtarisht shifër të saktë të numrit të banorëve për atë pjesë të vendit. Udhëheqësit e Komunës së Zubin Potokut pretendojnë që në atë pjesë jetojnë mbi 20.000 qytetarë. Në Ligjin e miratuar nga Kuvendi i Kosovës për Financat e Pushtetit Lokal ku specifikohen edhe karakteristikat e ndarjes së granteve për komuna, precizohet se Komuna e Zubin

¹⁸ Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave. Raporti vjetor i buxhetit 2012. Burimi: <http://mf.rks.gov.net/sq-al/ministriaefinancave/buxhetiirepublikessekosoves/buxhetiendrore.aspx>

Potokut do të tërheq grant nga niveli qendror për 15.000 banorë.¹⁹ Zubin Potoku është i njohur për liqenin e Ujmanit (Gazivodes).

Kryetar i Komunës së Zubin Potokut është Sllavisha Ristiq i cili vjen nga radhët e Partisë Demokratike të Serbisë. Ai e ushtron këtë pozitë që nga viti 2004. Nën kryetar është Sretan Duroviq nga subjekti politik Partia Socialiste e Serbisë. Në zgjedhjet lokale të organizuara në vend nga institucionet e Kosovës në fund të vitit 2009, nga Komuna e Zubin Potokut kanë votuar gjithsej 498 votues dhe të gjithë nga fshati Çaber. Ky numër ka rezultuar me vetëm 6% të votueseve të regjistruar nga Komuna e Zubin Potokut dhe kjo e ka shtyrë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) që mos t'i certifikojë zgjedhjet për Komunën e Zubin Potokut.²⁰ Kuvendi Komunal i Zubin Potokut përbëhet nga përfaqësuesit e zgjedhur nga zgjedhjet e shpallura nga Serbia të mbajtura më 11 maj 2008. Kuvendi përbëhet nga 31 anëtarë, ku Partia Demokratike e Serbisë ka 19 ulëse, Partia Socialiste e Serbisë ka nëntë ulëse dhe Partia Radikale e Serbisë ka tri ulëse. Kryetari i Komunës Sllavisha Ristiq ka bashkëpunim të ngushtë me këtë Kuvend i cili nga autoritetet e Prishtinës konsiderohet jo legal dhe jo legjitim.

Komuna e Zubin Potokut ka gjithsej gjashtë Drejtori: Drejtorinë e Çështjeve Sociale, Drejtorinë e Urbanizmit, Drejtorinë për Zhvillim dhe Financa, Drejtorinë e Kadastrit, Drejtorinë e Administratës si dhe Drejtorinë e Arsimit dhe Shëndetësisë.²¹

Kryetari aktual i Zubin Potokut Sllavisha Ristiq merr pagë edhe nga buxheti i Kosovës, si dhe nga Qeveria e Serbisë. I vetmi organ i cili respekton dhe zbaton ligjet e Kuvendit të Kosovës në atë pjesë të vendit është Zyra Komunale për Komunitete e cila është në fshatin Çaber të Zubin Potokut.²²

Në tenderët e shpallur nga Komuna e Zubin Potokut inkurajohen kompanitë nga Serbia për të aplikuar në këta tenderë.²³ Ka raste kur për një fushë të caktuar nuk ka interesim nga kompanitë e Serbisë për të aplikuar në tenderët e shpallur nga Zubin Potoku dhe për rrjedhje udhëheqësit e kësaj komune shpallin tender duke dërguar njoftimin në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik të Kosovës. Referimi në arkivin e kësaj faqe rezulton me vetëm pesë njoftime të dërguara në këtë komision nga Komuna e Zubin Potokut.²⁴

¹⁹ Kuvendi i Kosovës. Ligji për Financat e Pushtetit Lokal. Burimi: http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L049_al.pdf

²⁰ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Statistikat sipas Komunave. 2010. Burimi: <http://www.kqz-ks.org/SKQZ>

[WEB/al/zgjedhjetekosoves/materiale/rezultatet2009/komune/StatisticByMunicipality.pdf](http://www.kqz-ks.org/SKQZ)

²¹ Ueb faqja zyrtare e Komunës së Zubin Potokut. Struktura administrative e komunës. Burimi:

http://www.zubin-potok.org.rs/so_zubin_potok_files/so_zubin_potok.htm#

²² Bisedë me Qerkin Veselin – udhëheqës i Zyrës Lokale për Komunitete në Zubin Potok. Bisedat janë zhvilluar me datë 11.12.2012 & 12.12.2012 & 19.12.2012.

²³ Ueb faqja zyrtare e Komunës së Zubin Potokut. Struktura administrative e Komunës. Burimi:

http://www.zubin-potok.org.rs/so_zubin_potok_files/so_zubin_potok.htm#

²⁴ Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Ueb faqja zyrtare. Burimi: krpp.rks-gov.net/

Tabela nr.3: Kontratat e lidhura me procedurë të prokurimit në Zubin Potok në 2012 sipas fushës së investimeve, kostos, vitit dhe kompanive punë kryese

Projekti	Shuma (euro)	Viti	Kompania
Furnizim me 2 automjete për nevojat e Komunës së Zubin Potokut	62.000	2012	Auto-teknik "Baholli"- Prishtinë
Ndërtimi i ujësjellësit – Rritja e kapacitetit të ujësjellësit ekzistues në komunën e Zubin Potokut	152.185	2012	"Haxha com" - Skenderaj
Rikonstruktimi i rrugëve deri te objektet e institucioneve shëndetësore në komunën e Zubin Potokut	123.188	2012	"Termo Vod" - Graçanicë & "Vision Projekt" - Prishtinë
Ndërtimi i qendrës multifunksionale	344.688	2012	"Loshi Compani" - Mitrovicë

Buxheti i ndarë nga Qeveria e Kosovës për Komunën e Zubin Potokut në vazhdimësi ka pasur trend të rritjes, ndonëse kjo komunë në tri vitet e fundit nuk ka raportuar për mbledhjen e të hyrave komunale. Në nëntë mujorin e vitit 2012, nga Komuna e Zubin Potokut nuk është regjistruar asnjë euro e hyrë, ngjashëm si në vitin 2011.²⁵ Zyra e Auditorit të Përgjithshëm nuk ka qenë në gjendje të bëjë auditimin për Komunën e Zubin Potokut për vitin 2011 për shkak të refuzimit të tyre për bashkëpunim dhe raportim.²⁶

Tabela nr.4: Shuma e mjeteve që ka ndarë Qeveria e Kosovës për Komunën e Zubin Potokut në tri vitet e fundit.²⁷

Kategoria	2010	2011	2012
Investime Kapitale	524.562	666.737	727.632
Subvencione	7.614	7.853	7.853
Shpenzime komunale	8.000	11.392	11.392
Mallra dhe shërbime	78.306	85.979	92.439
Paga	972.003	1.298.069	1.147.368
Gjithsej	1.590.485	2.070.030	1.986.684

Nga tabela e mësipërme vihet në pah se Komuna e Zubin Potokut në tri vitet e fundit ka shpenzuar nga buxheti i Kosovës mbi 5.6 milionë euro. Pjesa dërmuese e këtyre mjeteve janë dhënë për paga. Të gjithë mësimdhënësit serb tërheqin paga nga buxheti i Kosovës

²⁵ Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave. Raporti vjetor i buxhetit 2012. Burimi: <http://mf.rks.gov.net/sq-al/ministriaefinancave/buxhetiirepublikessekosoves/buxhetiendrore.aspx>

²⁶ Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për Komunën e Zubin Potokut për vitin 2011. Burimi: http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KZP_2011_Shqip_848751.pdf

²⁷ Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave. Raporti vjetor i buxhetit 2012. Burimi: <http://mf.rks.gov.net/sq-al/ministriaefinancave/buxhetiirepublikessekosoves/buxhetiendrore.aspx>

si dhe një pjesë e administratës komunale duke përfshirë edhe Kryetarin e Komunës.²⁸ Afro 1.2 milionë euro është shuma e mjeteve vjetore që alokohen në kategorinë e pagave për Komunën e Zubin Potokut nga buxheti i Kosovës.²⁹

Në tri vitet e fundit, numri i personave që tërheqin paga nga buxheti i Kosovës në Komunën e Zubin Potokut ka qenë zakonisht mbi 300 persona. Kësisoj, në vitin 2010 kanë qenë 323 persona nga kjo komunë që kanë marrë paga nga buxheti i Kosovës, një vit me vonë ky numër është zvogëluar për dy persona, ndërsa në vitin 2012 numri i tyre është rritur në 337 persona.

4. Komuna e Leposaviqit

Komuna e Leposaviqit gjendet në skajin e fundit të veriut të Kosovës. Ajo kufizohet me Serbinë në veri dhe lindje, me Malin e Zi në jug, me Komunën e Mitrovicës dhe Zveçanit në jug-perëndim si dhe me Komunën e Podujevës në veri-perëndim. Edhe kjo Komunë, ngjashëm si Zubin Potoku dhe Zveçani kanë refuzuar t'i bashkëngjiten regjistrimit të popullsisë. Si rrjedhojë, nuk dihet numri i saktë i banorëve në atë pjesë të vendit. Udhëheqësit e Komunës së Leposaviqit aludojnë që në atë territor jetojnë mbi 14.000 qytetarë.³⁰ Por, në Ligjin e miratuar nga Kuvendi i Kosovës për Financat e Pushtetit Lokal ku specifikohen edhe karakteristikat e ndarjes së granteve për komuna, precizohet se Komuna e Leposaviqit do të tërheq grant nga niveli qendror për 19.000 banorë.³¹ Kjo Komunë përbëhet nga 46 fshatra dhe një zonë urbane.³² Nga këto fshatra, tri janë të populluara me popullatë shqiptare, konkretisht fshatrat Bistricë, Kushtovë dhe Cerajë. Kjo komunë jo zyrtarisht njihet edhe si Komuna e Albanikut.

Komuna e Leposaviqit udhëhiqet nga Kryetari Dragisha Vasiq i cili e ushtron këtë pozitë nga korriku i vitit 2012, i ardhur pas zgjedhjeve ilegale të organizuara nga ana e Qeverisë së Serbisë. Dragisha Vasiq e përfaqëson Partinë Përparimtare të Serbisë, ndërsa nënkryetar i Komunës është Millomir Kuzmanoviqi nga Partia Socialiste e Serbisë.³³ Ardhja si Kryetar komune e Dragisha Vasiqit ka larguar nga pozita kryetarin Branko Ninić, i cili pozitën e kryetarit e pat marrë nga zgjedhjet lokale të organizuara në

²⁸ Bisedë me Qerkin Veselin – udhëheqës i Zyrës Lokale për Komunitete në Zubin Potok. Bisedat janë zhvilluar me datë 11.12.2012 & 12.12.2012 & 19.12.2012

²⁹ Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave. Raporti vjetor i buxhetit 2012. Burimi: <http://mf.rks-gov.net/sq-al/ministriaefinancave/buxhetiirepublikessekosoves/buxhetiendrore.aspx>

³⁰ Ueb faqja Zyrtare e Komunës së Leposaviqit. Informacionet e përgjithshme. Burimi: <http://www.leposavic.org/Opste-Informacije/Opste-informacije.html>

³¹ Kuvendi i Kosovës. Ligji për Financat e Pushtetit Lokal. Burimi: http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L049_al.pdf

³² Kuvendi i Kosovës. Ligji për Ndarjen e Kufijve Administrativ të Komunave. Burimi: http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L049_al.pdf

³³ Bisedë me Haki Imerin, udhëheqës i Zyrës Lokale për Komunitete në Leposaviq. Biseda është zhvilluar me datë 11.12.2012.

vitin 2004 nga institucionet e Kosovës dhe Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK).

Kuvendi Komunal i Leposaviqit përbëhet nga 31 persona dhe që të gjithë janë serbë. Pjesën më të madhe të vendeve e mbajnë Partia Nacionale Serbe me nëntë vende, pastaj vjen Partia Përparimtare e Serbisë me tetë vende, Partia Socialiste e Serbisë me shtatë vende dhe pjesa tjetër përfaqësohet nga partitë tjera të regjistruara në Serbi.³⁴

Komuna e Leposaviqit ka një organ të quajtur Këshilli Komunal i Drejtorëve dhe shtatë Drejtori Komunale të cilat janë: Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Planifikimit, Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë, Drejtoria për Financa, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim. Të gjitha këto organe punojnë sipas ligjeve të Serbisë dhe forma e ndërtimit të tyre është bazuar në kriteret e caktuara nga modeli i aplikuar në Serbi për vetëqeverisje lokale.

Komuna e Leposaviqit nuk shpall asnjëherë tender për rregullimin e çështjeve publike në komunë. Kjo e drejtë i takon 'Këshillit të Drejtorëve' të cilëve ju dorëzohen ofertat nga operatorët ekonomik dhe ky këshill vendos për kompaninë të cilës do t'i besohet kryerja e punëve të caktuara. Asnjë shpallje tenderi në pesë vitet e fundit nuk është dërguar si njoftim në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik të Kosovës.³⁵

Udhëheqësit e Leposaviqit të vetmen gjë që nuk e refuzojnë nga institucionet e Kosovës është buxheti që i ndahet kësaj komune nga granti për komuna i Qeverisë së Kosovës. Shuma e buxhetit më së shumti shfrytëzohet për paga. Mësimdhënësit në këtë komunë në përgjithësi i marrin pagat edhe nga buxheti i Kosovës. Kjo ndodh edhe me një pjesë të stafit administrativ të komunës. Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive nuk marrin paga nga buxheti i Kosovës, ngase Ministria e Financave ka refuzuar futjen e tyre në lista pasi që ata janë zgjedhur në zgjedhjet lokale të organizuara nga Republika e Serbisë.³⁶

³⁴ Web faqja Zyrtare e Komunës së Leposaviqit. Lista e anëtarëve të Kuvendit. Burimi: <http://www.leposavic.org/Opstinska-administracija/Skupstina-opstine.html>

³⁵ Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik të Kosovës. Tabela e shpalljeve. Komuna e Leposaviqit. Burimi: <http://krpp.rks-gov.net/>

³⁶ Bisedë me Haki Imerin, udhëheqës i Zyrës Lokale për Komunitete në Leposaviq. Biseda është zhvilluar me datë 11.12.2012.

Tabela nr.5: Shuma e mjeteve që ka ndarë Qeveria e Kosovës për Komunën e Leposaviqit në tri vitet e fundit.³⁷

Kategoria	2010	2011	2012
Investime Kapitale	521.859	904.956	1.080.578
Subvencione	17.403	7.635	7.635
Shpenzime komunale	23.573	26.189	30.410
Mallra dhe shërbime	328.476	209.460	220.974
Paga	1.252.821	1.721.139	1.610.600
Gjithsej	2.144.132	2.869.379	2.950.197

Nga tabela e mësipërme shihet se Komuna e Leposaviqit në tri vitet e fundit ka shpenzuar nga buxheti i Kosovës mbi 8 milionë euro. Pjesa dërmuese e këtyre mjeteve janë dhënë për paga. Vetëm për paga në tri vitet e fundit për Komunën e Leposaviqit janë dedikuar mbi 4.5 milionë euro. Numri i personave nga Komuna e Leposaviqit që tërheqin paga nga buxheti i Kosovës është dukshëm më i madh krahasuar me Komunën e Zveçanit dhe atë të Zubin Potokut. Kësisoj, në vitin 2010 ka qenë 458 persona nga kjo komunë që kanë tërhequr paga nga buxheti i Kosovës. Një vit më vonë (2011), numri ka rënë për 21 persona, ndërsa në vitin 2012 numri ka shënuar rritje ku gjithsej 470 persona nga Komuna e Leposaviqit marrin paga nga buxheti i Kosovës.

Komuna e Leposaviqit, ngjashëm si Komuna e Zveçanit dhe ajo e Zubin Potokut, që nga periudha e pas vitit 2000 nuk i kanë konsoliduar organet për mbledhjen e të hyrave komunale. Në këto tri komuna, nuk paguhet tatimi në pronë, taksat e biznesit si dhe nuk ekziston e rregulluar forma e lëshimit dhe kompensimit të lejes së ndërtimit. Nga viti 2000 deri në vitin 2010, kur ka pasur një bashkëpunim të pjesshëm mes këtyre komunave dhe institucioneve të Kosovës të nivelit qendror, dhe asnjëherë nuk është raportuar për ndonjë të hyrë financiare nga këto komuna.³⁸

5. Zyra Administrative e Mitrovicës së Veriut

Procesi i decentralizimit në vend i nisur në disa zona si pilot projekt në vitin 2006 është bërë prioritet për institucionet e Kosovës në gjysmën e parë të vitit 2007. Kornizat e këtij procesi janë paraparë në Propozimin Gjithpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të

³⁷ Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave. Raporti vjetor i buxhetit 2012. Burimi: <http://mf.rks.gov.net/sq-al/ministriaefinancave/buxhetiirepublikessekosoves/buxhetiendrore.aspx>

³⁸ Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për Komunën e Leposaviqit për vitin 2010. Burimi: http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KLP_2010_Shqip_558739.pdf

Kosovës apo i njohur ndryshe si Pako e Ahtisarit.³⁹ Nga procesi i decentralizimit janë krijuar Komuna e Graçanices, Komuna e Parteshit, Komuna e Klllokotit, Komuna e Ranillugut, Komuna e Hanit të Elezit, Komuna e Junikut, Komuna e Mamushes dhe janë zgjeruar administrativisht dhe gjeografikisht Komuna e Novobërdës dhe Komuna e Shtërpçës. Prosesi i decentralizimit, i bazuar në konceptin e Pakos së Ahtisarit, akoma nuk konsiderohet i mbyllur, ngase nuk është krijuar Komuna e Mitrovicës së Veriut. Të rasti i Mitrovicës, Pakoja e Ahtisarit është bazuar në konceptin “një qytet-dy komuna”. Vonesat në krijimin e komunës së veriut në Mitrovicë kanë ardhur nga refuzimet e serbëve lokal të cilët të ndikuar nga politika zyrtare të Serbisë kanë kundërshtuar Pakon e Ahtisarit, e si pasojë edhe përpjekjet e institucioneve të Kosovës për të nisur me krijimin e Komunës të Mitrovicës së Veriut kanë stagnuar.

Hapi më konkret në formimin e kësaj komune është bërë në muajin maj të vitit 2012 me nënshkrimin e vendimit nga Qeveria e Kosovës e cila parasheh formimin e Zyrës Administrative për Mitrovicën e Veriut.⁴⁰ Për dallim nga komunat tjera, ku kryetari zgjidhet drejtpërdrejt nga votat e qytetarëve, udhëheqësi i Zyrës Administrative të Mitrovicës së Veriut është paraparë të zgjidhet me konkurs publik, dhe ngjashëm është vepruar edhe me zgjedhjen e zyrtarëve të lartë të kësaj zyre të cilët kanë funksione të njëjta me Drejtorët e Drejtorive në Komunat e tjera të vendit.⁴¹

Hierarkia udhëheqëse e kësaj zyre përbëhet nga Udhëheqësi ekzekutiv (kryetari), zëvendës i udhëheqësit ekzekutiv (nënkryetari), si dhe janë krijuar shtatë drejtori: Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria për Çështje të Komuniteteve dhe Marrëdhënieve me Publikun, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mbrojtje Sociale, Drejtoria e Urbanizimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, dhe Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport.⁴² Kjo zyre, përveç Udhëheqësit ekzekutiv, zëvendësit të tij si dhe shtatë drejtorëve të drejtorive, ka edhe 72 persona të tjerë të punësuar që janë të shpërndarë në drejtori të ndryshme të kësaj zyre si dhe në Qendrën për Punë Sociale dhe në Bibliotekën e veriut. Udhëheqësi Kryesor Ekzekutiv i zyrës preferohet të jetë së paku 3 vite banor i Mitrovicës Veriore si dhe të jetë pjesëtar i grupit etnik shumicë në atë pjesë, i cili duhet të jetë në gjendje të përfaqësojë të gjitha komunitetet etnike. Kriteret e përzgjedhjes përgatiten nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Udhëheqësi Kryesor Ekzekutiv do të mbështetet nga një këshilltar ndërkombëtar i emëruar nga Ministri i Administrimit të

³⁹ Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjedhjen e Statusit të Kosovës. Burimi:

http://www.unosek.org/docref/Comprehensive_proposal_-_Propozimi_gjith%EBp%EBfshir%EBs_-_albanian_final.pdf

⁴⁰ Qeveria e Kosovës. Zyra e Kryeministrit. Vendimi 01/75. Data 23.05.2012. Burimi:

http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_75-te_te_Qeverise_se_Republikes_se_Kosoves_2012.pdf

⁴¹ Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Shpallje për vende të lira pune. Burimi: [http://mapl.rks.gov.net/getattachment/Main-menu/Shpallje/Vende-te-lira-pune/Announcement/Konkurs-per-vende-te-lira-pune-versioni-f-\(2\).pdf.aspx](http://mapl.rks.gov.net/getattachment/Main-menu/Shpallje/Vende-te-lira-pune/Announcement/Konkurs-per-vende-te-lira-pune-versioni-f-(2).pdf.aspx)

⁴² Zyra Administrative e Mitrovicës së Veriut. Bisedë më Drejtorin e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme Mursel Ahmeti. Biseda është zhvilluar me datë 24.12.2012.

Pushtetit Lokal.⁴³ Kjo zyre aktualisht udhëhiqet nga Adrijana Hodziç, e cila është zgjedhur për një periudhë katër vjeçare me mundësi të vazhdimit të mandatit.

Zyra Administrative e Mitrovicës së Veriut, tani ka të hapur edhe ueb-faqen zyrtare në internet e cila ngjason komplet me faqet zyrtare të komunave tjera të vendit. Hapja dhe menaxhimi i kësaj faqe kuptohet si indikacion i forcimit dhe konsolidimit të ngadaltë të kësaj zyre.⁴⁴

Në shtatë muajt e parë të funksionimit të Zyrës Administrative të Mitrovicës së Veriut (qershor – dhjetor 2012), nga kjo zyre janë koordinuar disa investime në disa fusha të Mitrovicës së Veriut. Kësisoj, është rregulluar kulmi në ndërtesën publike në rrugën “Kollashini”, është rindërtuar parku dhe sheshi i lojërave për fëmijët në mes të rrugëve “Kral Petar” dhe “Tanaska Rajic”, është rregulluar përroi i ujërave duke instaluar kolektor në fshatin Suhodoll, pastaj është krijuar një kënd për fëmijë në zonën e quajtur Bishevc, po ashtu janë gëlqerosur disa ndërtesa publike në rrugën “Vlade Cetkoviç” si dhe asfaltimi i rrugës kryesore në lagjen e “Boshnjakëve”. Nga të dhënat zyrtare rezulton se për shtatë muajt e parë të funksionit të kësaj zyre janë mbi tre mijë serbë lokal që kanë kërkuar dhe pranuar shërbime nga Zyra Administrative e Mitrovicës së Veriut.⁴⁵

Menjëherë pas vendimit për themelimin e Zyrës Administrative të Veriut, Ministria e Financave ka dedikuar buxhet për këtë zyre dhe njëherazi e ka inkorporuar këtë zyre në kategorinë e organizatave buxhetore të vendit duke e radhitur në mesin e komunave tjera.

Tabela nr.6: Shuma e mjeteve që ka ndarë Qeveria e Kosovës për Zyrën Administrative të Mitrovicës së veriut.⁴⁶

Kategoria	2012
Investime Kapitale	1.117.774
Subvencione	10.000
Shpenzime komunale	57.359
Mallra dhe shërbime	159.711
Paga	1.444.655
Gjithsej	2.789.499

⁴³ Zyra Administrative e Mitrovicës së Veriut. Plani për themelimin e Zyrës Administrative të Mitrovicës së Veriut. Burimi: <https://kk.rks-gov.net/mnao/getattachment/Municipality/Government-Decision/GOK-DECISION-ANNEX-Alb.pdf.aspx>

⁴⁴ Zyra Administrative e Mitrovicës së Veriut. Ueb faqja zyrtare. Burimi: <https://kk.rks-gov.net/mnao/Home.aspx>

⁴⁵ Portali “Zeri.info”. Data 12.11.2012. Burimi: <http://www.zeri.info/artikulli/1/1/61764/zyra-administrative-shqyrton-mbi-2-mije-kerkesa-ne-veri/> & Gazeta “Epoka e Re” numër 28 dhjetor 2012. Fq 1-3. Intervistë më Adrijana Hodziç.

⁴⁶ Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave. Raporti vjetor i buxhetit 2012. Burimi: <http://mf.rks-gov.net/sq-al/ministriaefinancave/buxhetiirepublikesekosoves/buxhetiendrore.aspx>

Buxheti i dedikuar për Zyrën Administrative të Mitrovicës së Veriut, në linjën për paga përfshin kryerjen e pagesave në kategorinë e pagave në administratën e zyrës dhe personelin tjetër gjegjës, si dhe për një numër të konsiderueshëm personash në sektorin e arsimit dhe atë të shëndetësisë të cilët marrin paga edhe nga buxheti i Kosovës por edhe nga ai i Serbisë. Nga buxheti i Kosovës sektori i arsimit dhe një pjesë e sektorit të shëndetësisë në veri të Mitrovicës kanë marruar paga edhe para formimit të Zyrës Administrative. Tërheqja e pagave është bërë nëpërmjet administratës së UNMIK-ut në Mitrovicën e Veriut, ndërsa parat janë dedikuar nga buxheti i Kosovës.

Zyra Administrative e Mitrovicës së Veriut problemin me të madh e ka në pamundësinë e shtrirjes së pushtetit në gjithë zonën e veriut të Mitrovicës, për shkak të pengesave dhe kundërshtimeve të hapura nga grupe dhe individ të cilët inkurajohen dhe financohen nga ana e Qeverisë së Serbisë. Edhe punonjësit e kësaj zyre që kryesisht janë serb lokal, u nënshtrohen kërcënimeve dhe presioneve nga këto grupe.⁴⁷

6. Përfundim

Shikuar nga pikëpamja e qeverisjes lokale, shkalla e zbatimit të Ligjeve të Kosovës është më e dukshme në Mitrovicën e Veriut, krahasuar me Komunitat e Leposaviqit, Zveçani dhe Zubin Potokut. Zyra Administrative e Mitrovicës së Veriut bazohet në strukturën e qeverisjes të përcaktuar për komuna nga ana e institucioneve të Kosovës, raporton tek institucionet e Kosovës dhe mban uebfaqe zyrtare me logo të Republikës së Kosovës, përderisa kjo nuk haset edhe në tri komunitat e veriut të Kosovës.

Komunitat e Veriut të Kosovës (Leposaviqi, Zveçani dhe Zubin Potoku) përgjithësisht refuzojnë parimet e vetëqeverisjes lokale të Kosovës. Deri në vitin 2010 udhëheqësit e këtyre komunave kanë mbajtur bashkëpunim të pjesshëm me disa nga Institucionet e Kosovës. Gjatë vitit 2011 nga këto komuna është refuzuar çfarëdo bashkëpunimi me institucionet e Kosovës, me përjashtim të marrjes së grantit nga buxheti i Kosovës i dedikuar për komuna.

Nga ana tjetër, Institucionet e Kosovës janë treguar të pafuqishme për të parandaluar qasjen e këtyre tri komunave të cilat në mënyrë të hapur shpërfillin parimet bazë të institucioneve të Kosovës.

Në tri vitet e fundit nga buxheti i Kosovës për këto tri komuna janë dedikuar afro 19 milionë euro, pa përfshirë këtu edhe parat e dedikuara për Zyrën Administrative të Mitrovicës së Veriut.

Lidhur me shpenzimet e buxhetit në këto Komuna, Ministria e Financave e Qeverisë së Kosovës ka refuzuar disa herë radhazi që të përgjigjet në kërkesat e Institutit GAP në

⁴⁷ Zyra Administrative e Mitrovicës së Veriut. Bisedë me Drejtorin e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme Mursel Ahmeti. Biseda është zhvilluar me datë 21.12.2012.

lidhje me raportet financiare që ka kjo Ministri për shpenzimet e buxhetit që bëjnë këto tri komuna. Mbajtja mbyllur e të dhënave zyrtare të kësaj fushe e bënë edhe më të pa qartë gjendjen sa i përket shpenzimeve buxhetore nga këto tri komuna..

Zyrat për Komunitete në Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok udhëhiqen nga shqiptarët dhe këto zyra ndonëse zyrtarisht numërohen pjesë të komunave përkatëse, funksionojnë jashtë objekteve komunale dhe përgjithësisht nuk kanë bashkëpunim me komunat nën ombrellën e të cilave janë. Këto Zyra kryejnë një rolë thelbësor në ofrimin e shërbimeve për qytetarët të cilët e pranojnë juridiksionin e shtetit të Kosovës.

Në këto tri komuna mbi një mijë persona marrin pagë nga Buxheti i Kosovës. Mbi 80% e tyre janë mësimdhënës. Asnjëri nga ata nuk nënshkruan kontratë me institucionet e Kosovës. Nga buxheti i Kosovës për këto tri komuna gjatë një viti për paga dedikohen afro katër milionë euro. Ministrinë e linjës së Qeverisë së Kosovës si Ministria e Administrimit të Pushtetit lokal, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në raportet e tyre vjetore nuk i përfshijnë të dhënat nga këto tri komuna me arsyetimin e mungesës së bashkëpunimit dhe raportimit.

Komunat e veriut të Kosovës udhëhiqen nga subjekte politike të regjistruara në Serbi. Strukturat e komunave në veri të vendit dallojnë nga strukturat e komunave tjera të Kosovës dhe po ashtu kompanitë private punë kryese në veri kryesisht kontrahohen nga Serbia.

Në raportet e bëra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP), para vitit 2010, vërehet se këto komuna asnjëherë nuk kanë ndërtuar mekanizma për vjeljen e të hyrave komunale. Nga kjo rezulton se bizneset dhe qytetarët në atë pjesë të vendit nuk i nënshtrohen asnjë lloj takse komunale apo takse tjetër.

7. Burimet:

1. Qeveria e Kosovës. Zyra e Kryeministrit. Vendimi 01/75. Data 23.05.2012. Burimi: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_75-te_te_Qeverise_se_Republikes_se_Kosoves_2012.pdf
2. Qeveria e Kosovës. Zyra e Kryeministrit. Zyra Ligjore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Rregullorja për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim. Burimi: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Rregullore_per_Zyrat_komunale_per_Komunitete_dhe_Kthim.pdf
3. Qeveria e Kosovës. Zyra e Kryeministrit. Vendimi 02/25. Data 03.07.2008. Burimi: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_25-te_te_Qeverise_2008.pdf
4. Komuna e Zveçanit. Sektorët Operativ në Komunë. Burimi: http://www.opstinazvecan.rs/index.php?option=com_content&view=category&layout=blog&id=46&Itemid=140&lang=rs
5. Web faqja zyrtare e Komunës së Zveçanit. Burimi: <http://www.opstinazvecan.rs/>
6. Qeveria e Kosovës. Ministria e Financave. Raporti vjetor i buxhetit 2012. Burimi: <http://mf.rks-gov.net/sq-al/ministriaefinancave/buxhetiirepublikessekosoves/buxhetiendrore.aspx>
7. Kuvendi i Kosovës. Ligji për Financat Publike. Burimi: <http://www.assembly-kosova.org/?cid=1,191,7>
8. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për Komunën e Zveçanit për vitin 2011. Burimi: http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KZV_2011_Shqip_978143.pdf
9. Kuvendi i Kosovës. Ligji për Financat e Pushtetit lokal. Burimi: <http://www.assembly-kosova.org/?cid=1,191,256>
10. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Statistikat sipas Komunave. 2010. Burimi: http://www.kqz-ks.org/SKQZ_WEB/al/zgjedhjetekosoves/materiale/rezultatet2009/komune/StatisticByMunicipality.pdf
11. Web faqja zyrtare e Komunës së Zubin Potokut. Struktura administrative e Komunës. Burimi: http://www.zubin-potok.org.rs/so_zubin_potok_files/so_zubin_potok.htm#
12. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Web faqja zyrtare. Burimi: <http://krpp.rks-gov.net/>
13. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për Komunën e Zubin Potokut për vitin 2011. Burimi: http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KZP_2011_Shqip_848751.pdf
14. Kuvendi i Kosovës. Ligji për Ndarjen e Kufijve Administrativ të Komunave. Burimi: http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L049_al.pdf
15. Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës. Burimi: http://www.unosek.org/docref/Comprehensive_proposal_-_Propozimi_gjith%EBp%EBrfshir%EBs_-_albanian_final.pdf
16. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Shpallje për vende të lira pune. Burimi: [http://mapl.rks-gov.net/getattachment/Main-menu/Shpallje/Vende-te-lira-pune/Announcement/Konkurs-per-vende-te-lira-pune-versioni-f\(2\).pdf.aspx](http://mapl.rks-gov.net/getattachment/Main-menu/Shpallje/Vende-te-lira-pune/Announcement/Konkurs-per-vende-te-lira-pune-versioni-f(2).pdf.aspx)

17. Zyra Administrative e Mitrovicës së Veriut. Plani për themelimin e Zyrës Administrative të Mitrovicës së Veriut. Burimi: <https://kk.rks-gov.net/mnao/getattachment/Municipality/Government-Decision/GOK-DECISION-ANNEX-Alb.pdf.aspx>
18. Zyra Administrative e Mitrovicës së Veriut. Ueb faqja zyrtare. Burimi: <https://kk.rks-gov.net/mnao/Home.aspx>
19. Portali "Zeri.info". Data 12.11.2012. Burimi: <http://www.zeri.info/artikulli/1/1/61764/zyra-administrative-shqyrton-mbi-2-mije-kerkesa-ne-veri/>
20. Zyra e Koordinuere e Qeverisë së Kosovës për Veri. Raporti mbi institucionet paralele në veri të Kosovës. Burimi: [http://www.kohaditore.com/repository/docs/Raporti_per_Veri_Maj_2011\[2\].pdf](http://www.kohaditore.com/repository/docs/Raporti_per_Veri_Maj_2011[2].pdf)
21. Bisedë me Haki Imerin, udhëheqës i Zyrës Lokale për Komunitete në Leosaviq.
22. Bisedë me Qerkin Veselin – udhëheqës i Zyrës Lokal për Komunitete në Zubin Potok.
23. Bisedë me Mursel Ahmetin – Drejtor i Drejtorisë së Administratës në Zyrën Administrative të Mitrovicës së Veriut.
24. Bisedë me Lulzim Pecin, përgjegjës në Zyrën Lokale për Komunitete në fshatin Lipë të Zveçanit.